# DËSHMI ARKIVI

**A-441307**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dokumentacionet e pronësisë në Palasë, Kadastra paralajmëron: Nga nesër nis kontrolli derë më derë \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/dokumentacionet-e-pronesise-ne-palase-kadastra-paralajmeron-nga-neser-nis-kontrolli-dere-me-dere/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:43:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 17:08:05 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `097204ce851b6111b41f3b7d5b7e7a5b5d625eb8beacb0ece4b7d17a63df7122` |
| TEKSTI | `23e5e08cc4a5aa8d007dccef4c1c8a8506ec19ac6777846c4c1cad478fa83fec` |
| PAMJA | `75b2d20be055cf4e0388044955ba7e8987091385ce2ff4c356ee80beafd9e9d9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `83e6c9e41794e1db6d0744aa726d5a04a26566a47c68817ee8aa780937f7b739` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/83e6c9e41794e1db6d0744aa726d5a04a26566a47c68817ee8aa780937f7b739`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Dokumentacionet e pronësisë në Palasë, Kadastra paralajmëron: Nga nesër nis kontrolli derë më derë



*Edi Hallaci*

*08 Shtator 2026*




Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka njoftuar nisjen e një procedure të re për trajtimin e banesave që nuk disponojnë dokumentacion pronësie.

Procesi do të nisë nesër në Palasë, ku ekipe të posaçme do të qëndrojnë për një javë dhe do të verifikojnë rastet drejtpërdrejt në terren.

Drejtoresha e Përgjithshme e Kadastrës, Lorena Goxhobelli, bëri të ditur se specialistët do të shkojnë derë më derë në çdo banesë, pavarësisht nëse pronarët kanë aplikuar më parë ose jo pranë institucionit.

**Njoftimi i plotë:**

Kadastra do të trajtojë banesat pa dokumentacion pronësie me një qasje tjetër. Përmes ekipeve të dedikuara e të lëvizshme, ne do të vijmë në fshatin tuaj në mënyrë të organizuar. E thënë ndryshe, Kadastra shkon derë më derë", u shpreh Goxhobelli.

Sipas saj, ekipet e Kadastrës do të trokasin në çdo banesë, pavarësisht nëse qytetarët kanë aplikuar më parë apo jo pranë këtij institucioni. Specialistët do të kryejnë matjet në terren, do të verifikojnë dhe saktësojnë dokumentacionin, ndërsa për çdo rast që plotëson kriteret ligjore do të merret vendimi përkatës, i cili do t'i dërgohet qytetarit direkt përmes platformës e-Albania.

Një tjetër element i rëndësishëm i këtij procesi do të jetë prania e vazhdueshme e ekipeve në zonat ku po kryhet puna. Kjo do t'u japë mundësi banorëve të komunikojnë drejtpërdrejt me specialistët dhe të informohen qartë për fazën në të cilën ndodhet dosja e tyre.

Procesi do të jetë transparent edhe pas përfundimit të punës në çdo zonë. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të publikojë statusin e të gjitha banesave të trajtuara, duke bërë të qartë se cilat prej tyre janë pajisur me vendim, cilat raste kërkojnë plotësimin e dosjes me dokumente që Kadastra

nuk mund t'i sigurojë vetë, siç mund të jetë dëshmia e trashëgimisë, si dhe rastet kur ekipet nuk kanë mundur të aksesojnë banesën.

Në këtë mënyrë, çdo qytetar do të informohet qartë për statusin e çështjes së tij dhe për hapat që duhet të ndërmarrë më tej.

Procesi nis nesër në Palasë, ku ekipet e Kadastrës do të qëndrojnë për një javë, me qëllim trajtimin e të gjitha banesave pa dokumentacion pronësie në këtë zonë. Më pas, nisma do të vijojë me radhë në fshatra të tjerë në të gjithë vendin.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës u ka bërë thirrje banorëve të Palasës të bashkëpunojnë me specialistët në terren, të njoftojnë familjarët, të afërmit dhe fqinjët, si dhe të sigurohen që gjatë vizitës së ekipeve të ketë një person në banesë për t'i pritur ata.

---

## LAJME TË NGJASHME



Ndryshon vettingu për policët, kërkohet që transferimi apo ulja në detyrë të mos ndërpresë procesin e verifikimit

1.5 MIN




Aksion policor ndaj makinave luksoze në Vlorë/ Sekuestrohen 3 mjete!

1.5 MIN



"Godisni grupet kriminale", Hita urdhër strukturave të Policisë në Korçë, Tiranë e Dibër: Kapni shtetasit në kërkim

1 MIN



"Task-forcat duhet të jenë efektive dhe funksionale", kreu i Inspektoratit të Përgjithshëm me direktiva të reja, zbardhen 'piketat'

3 MIN




Plagosja e dyfishtë në Laprakë, zbardhen rrethanat e ngjarjes, identifikohet autori që sulmoi dy shokët

1 MIN

## MË TË LEXUARAT



Flasin ekspertët/Gërhitja e partnerit nuk është thjesht bezdi, mund t'ju dëmtojë seriozisht shëndetin!



"Marshi për Liri" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK, qytetarët nisin grumbullimin në Prishtinë



Para verdiktit, Kosova përcjell edhe njëherë mesazhin për ish-krerët e UÇK-së



Aksident në Selenicë, automjeti del nga rruga dhe bie nga një lartësi të madhe, humb jetën shoferi



Lady Gaga bëhet nënë për herë të parë





Bëni kujdes me këto shenja të zodiakut/Për të flirtuar i keni 'ekspertë' por për lidhje serioze, harrojeni!



Ilaçi që mund të rikthejë flokët te personat me alopeci të rëndë…



Shenjat e zodiakut që luajnë "viktimën" edhe kur kanë faj!



6-vjeçarja bëhet virale në rrjet, nis shkollën e vetme në fshatin me 40 banorë!



Daja para derbit me Partizanin: Do fitojë ekipi që do të bëjë më pak gabime, duhet të jemi gjithë kohës në ekuilibër!

## EDITORI SUGJERON



Një dietologe tregon si të hani karbohidratet, proteinat, yndyrnat dhe fibrat për të kontrolluar...



Çfarë ndodh me trupin tuaj kur merrni ekstrakt çaji jeshil me kafeinë?!



Studim/Hemoglobina e ulët mund të çojë në...



Shumë njerëz e bëjnë çdo natë, por studimi i ri tregon një rrezik të fshehur!



Dëshironi të rregulloni kolisterolin?! Këto janë frutat që ju duhen...



Mendoni se po veproni mirë, por me këto ushqime po dëmtoni...



Kujdes! Këto ushqime nuk duhet t'i përzieni kurrë me vitaminën D...



Vaj ulliri me hudhër është i shëndetshëm për organizmin?! Ja se çfarë ndodh në të vërtetë...



Proteinat bimore apot proteinat shtazore?! Ja se cilat janë më të mira...



A duhet të stërviteni ndryshe gjatë menstruacioneve?! Përgjigjja mund t'ju befasojë...

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.


**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873



**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.



**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.